

## PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

PËR LINJEN E PRODHIMIT DHE AMBALAZHIMIT TË  
UJIT ACQUA PRIMA, (BURIMI SELITA) DHE TË PIJEVE  
JO ALKOLIKE

PËR KOMPANINË SECURITY FORCE – 98/Tiranë



*Përgatitur nga Departamenti i Gjeomjedisit - G & G group*

Tiranë, Maj 2014

## **NATYRA DHE PËRMBAJTJA E VNM**

VNM përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social. VNM është një proces që zhvillohet brenda procesit të planifikimit dhe zbatimit të projektit për të përmirësuar cilësinë e planifikimit të projektit në kushtet e një zhvillimi të qëndrueshëm. Në procesin e VNM, përdoret informacioni dhe të dhëna ekzistuese, si edhe ato të përfituara rishtazi mbi kushtet e shfrytëzimit të karrierës, së bashku me standartet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar ndikimet potenciale mjedisore dhe sociale të lehtësirave të propozuara.

Ngritja e një infrastrukture teknologjike pa studimin gjeologo-inxhinierik, sizmotektonik, hidrologjik, gjeomorfologjik, etj, kanë çuar në prishjen e disa ekuilibrave natyrorë, për faktin se këto ndërtime mund të shkatërrohen nga forcat vepruese të fatkeqësive natyrore dhe/ose njerëzore ose mund t'i shkatërrojnë ato. Bizneset dhe investimet e kryera për realizimin e këtij zhvillimi teknologjike sjellin, si ngritje të infrastrukturës teknologjike, ashtu edhe dobi në ecurinë e jetës ekonomike të vendit sepse:

- Rritet klientela frekuentuese, e cila është e interesuar të përfitojë më tepër shërbim, më tepër shpejtësi dhe më tepër siguri në biznesin e ri që do të krijohet;
- Ruhen më mirë vlerat dhe parametrat ekologjik të mjedisit.

*VNM është një mjet, që i tregon vendim-marrësve dhe publikut pasojat ambientale të projekteve, në mënyrë që ato të mund të modifikohen dhe të mund të evitohen dëmtimet e mjedisit, gabimet në ndërtim dhe humbjet ekonomike, që vijnë nga efektet negative direkte ose indirekte.*

Në procesin studimor të VNM, përdoren informacione dhe të dhëna ekzistuese dhe të përfituara rishtaz mbi kushtet e shesheve të ndërtimit, së bashku me standartet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar ndikimet potenciale mjedisore dhe sociale të lehtësirave të propozuara.

### **Prezantimi i Projektit**

Shoqëria “SECURITY FORCE – 98”, sh.p.k. do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë çdo iniciativë vëzhguese mjedisore, që do t'i këshillohet në “Lejen Mjedisore”, në shërbim të së cilës është kryer edhe ky raport. Gjithashtu, inspektimet nga specialistët e autorizuar të shëndetit publik dhe mjedisit do të mbështeten në çdo kohë për realizimin e auditimeve mjedisore dhe shëndetësore.

### ***Përshkrimi i projektit***

Në këtë kapitull paraqitet një përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar dhe konteksti i tij gjeografik, ekologjik, social dhe kohor, duke përfshirë edhe ndonjë investim që mund të kërkohet jashtë vendit të projektit.

### ***Kushtet fillestare të vendit***

Ky seksion i VNM paraqet rezultatet e një vlerësimi të dimensioneve të zonës së studimit dhe përshkruan kushtet përkatëse fizike, biologjike dhe social-ekonomike, duke përfshirë edhe ndonjë

## **Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike**

ndryshim para se të fillonte projekti. Vlerësimi merr në konsideratë aktivitetet aktuale të zhvillimit dhe ato të propozuara brenda zonës së projektit ose që nuk lidhen direkt me projektin.

### ***Përshkrimi i vend-ndodhjes***

Zona në studim shtrihet në lindje të qytetit të Tiranës. Kufijtë e zonës së propozuar për studim janë: Linjë prodhimi Biter, (veri), rrugë (jug), mali i Dajtit (lindje) e përrua (perëndim). Territori përreth është kryesisht i pjerrët, me një pjerrësi rreth 30% nga lindja në perëndim, ndërsa fabrika ngrihet mbi një sipërfaqe të sheshtë. Rajoni në studim karakterizohet nga pika të forta dhe të dobëta, që lidhen me demografinë dhe situatën shoqërore, strukturën ekonomike, zhvillimin hapësinor dhe përdorimin e tokës, infrastrukturën sociale, teknike dhe komunale, kushtet natyrore dhe mjedisin, kuadrin e përgjithshëm dhe institucionet. Rajoni ndodhet shumë pranë kryeqytetit.



Zhvillimi i qëndrueshëm në rajon do të jetë udhëzuesi kryesor për ndërhyrjet. Për këtë duhet që konsideratat ekonomike, shoqërore e ekologjike të ekuilibrohen me mirë zhvillimin rajonal.

### ***Ndotja e ajrit dhe zhurmat***

Zhurmat e emetuara nga operimi i linjës do të jenë sipas standarteve ndërkombëtare të 70-75dB për zonat tregtare/industriale. Transmetimet e energjisë duhet të jenë të tilla për t'u siguruar se zhurma nuk i kalon 85dB (A) në një minutë. Ndotja e ajrit do të jetë në nivele të kontrolluar. Vetë linja është e pajisur me filtra të cilat ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit.

### ***Kërkesat Sociale***

Duke pasur parasysh kushtet social-ekonomike të zonës në studim, ky rajon do të ketë përfitime nga kjo linjë. Nuk pritet që ndërtimi të shkaktojë një fluks të veçantë njerëzish të ardhur nga zonat e tjera. Gjatë periudhës së funksionimit të linjës do të punojnë afërsisht 10 punëtorë. Pjesa më e madhe e forcës punëtore në zonën në studim ka përfunduar studimet e mesme.

### ***Vlerësimi i rrezikut***

Metoda e vlerësimit të rrezikut është quajtur “modeli linear jo prag“. Pretendohet se nuk ka prag të nivelit të ekspozimit, poshtë të cilit rreziku është zero. Gjithashtu, pretendohet se rreziku rritet proporcionalisht me ekspozimin. Në qoftë se qendrimi në punë dyfishohet dhe rreziku gjithashtu dyfishohet. Rreziku që rezulton nga një qendresë e gjatë ose nga mos zbatimi i masave të sigurimit teknik do të shkaktojë një efekt të madh ose të vogël në shëndetin e njeriut, që varet edhe nëse varësia është direkte ose indirekte (i brendshëm ose i jashtëm). Specialistët përdorin metoda të ndryshme për të vlerësuar rrezikun nga ekspozimi i gjatë ose nga mos zbatimi i masave të sigurimit teknik. Përdoren metoda të ngjashme për të vlerësuar rrezikun nga këto shkaqe. Megjithatë, vlerësimet përfshijnë paqartësi, për shkak të kundërshtimeve të shumta në bërjen e matjeve, sepse zhvillimi i një procesi ekspozimi mund të jetë shumë i vështirë;

## QËLLIMI I VNM

Qëllimi i VNM, është që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraprak të parametrave ekologjik, të treguesve hidrogeologjikë e hidrologjikë, të kushteve gjeologo-inxhinierike (vetitë fiziko-mekanike), parametrave sizmo-tektonik, morfologjik e gjeomorfologjik, të bazuara në kriteret standarte shkencore ndërkombëtare, sipas Konventave Ndërkombëtare e Kombëtare të tipizohen dhe të përzgjidhen, një sërë parametrash dhe veçorish të sistemeve natyrorë, në shërbim të menaxhimit të infrastrukturës mjedisore, të mbrojtjes së aksidenteve, të përmirësimit të kushteve të punës brenda linjës etj. Ky raport vlerësimi ka për qëllim,.

- Paraqitjen e gjendjes sa më reale, nga pikëpamja e ndikimit të këtij zhvillimi urban, mbi mjedisin natyror dhe human;
- analizimin e faktorëve pozitivë e negativë mjedisore;
- dhënien e masave zbutëse për zvogëlimin e ndikimeve negative;
- planin e menaxhimit lokal dhe monitorimet për zërat përkatëse.

## Metodika

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga madhësia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse, duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të projektit. Në këtë studim identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive, sidomos në kompesime indirekte mbi komunitetin. Studimi është kryer duke u ndarë në katër faza kryesore:

1. Ngritja e objektivave orientuese të projekt-studimit;
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe atij të formuluar enkas për këtë projekt dhe seleksionimi i saj për përdorim;
3. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme biofizike dhe humane;
4. Hartimi i projektit dhe dorëzimi tek porositësi, si dhe tek subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele lokale;

## TEKNOLOGJIA E PËRPUNIMIT DHE AMBALAZHIMIT TË UJIT ACQUA PRIMA

### *Teknologjia e Përpunimit të ujit Acqua Prim (burimi Selitë)*

Projekti teknik synon në marrjen e ujit të burimit Selitë dhe përpunimin e tij deri në standartet sipas Institutit të Higjenës dhe Shëndetit, si dhe në shitjen për konsum. Pas shqyrtimit të rezultateve të analizave të ujit të Pocemit nga grupi i ekspertëve të huaj, rezultoi se duhet përdorur teknologjia e mëposhteme për ujin mineral para se të dërgohet në linjen e ambalazhimit:

Mbi cilësinë dhe sigurinë e ujit të ambalazhuar

Vlerat e parametrave fiziko – kimikë, toksikologjikë dhe bakteriologjikë arrihen nëpërmjet:

## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike

- kushteve që duhet të plotësojë burimi nga i cili merret uji;
- tubacionet e përdorur (përbërja, seksioni, gjatësia)
- depoja e grumbullimit të ujit para hyrjes në impiant;
- mënyra e hyrjes së ujit në linjën e prodhimit;
- teknologjia e prodhimit (llojet e filtrave të përdorur, ambalazhimi, taposja);
- magazinimi (kushtet, temperatura e magazinimit, ), transporti, tregëtimi;
- kushtet higjieno – sanitare në vendin e prodhimit;
- personeli (veshjet, gjendja shëndetësore).

Qëllimi i studimit të ujit të pijshëm është që të bëhet:

1. Vlerësimi i cilësisë dhe sigurisë së ujit të ambalazhuar (treguesit fiziko – kimikë, toksikologjikë, bakteriologjikë).
2. Njohja me teknologjinë e prodhimit, vlerësimi i PKK (pikave kritike të kontrollit),
3. Evidentimi i të metave në procesin e prodhimit apo ambalazhimit si dhe inspektim të kushteve higjieno – sanitare.
4. Zbatimi i sistemit të autokontrollit apo HACCP (Hazard Critical Control Point) sipas standarteve të Bashkimit Europian.
5. Vlerësimin e riskut mbi konsumatorin.
6. Rekomandime mbi përmirësimin e cilësisë së ujit të ambalazhuar.

## Filtrimi i ujit

Filtrimi është operacion teknologjik, në të cilin bëhet ndarja e fazave të ngurta nga suspensioni. Të gjitha këto përbëjnë pastërinë e ujit. Uji vlerësohet me shkallë të lartë të pastërtisë, tejdukshëmisë. Për të fituar ujë me tejdukshmëri të lartë duhet bërë kthjellimi artificial i saj. Proceset kryesore të kthjellimit janë: filtrimi, pasterizimi dhe rrezatimi me ultraviolet. Për këtë arsye, procesi i filtrimit bëhet me presion më të lartë se sa presioni që ka vepruar në bodrum në fazën e ardhjes. Filtrat mekanik kanë një karakteristikë të përbashkët, sepse janë elemente poroze të renditura njëra pas tjetrës në pozitë vertikale ose horizontale, ku në mes tyre formohen hapësirat e zbrazëta për t'u formuar pogaqja filtruese.

*Paisjet e propozuara për këto teknologji janë:*

- Gjenerator ozoni ( prodhues i Ozonit ne vend)
- Komprimues Oksigjeni për prodhimin e Ozonit;
- Injektor i Ozonit
- Pompe Uji
- Tank 500 litersh për reaktorin e Ozonit;
- Fuqia e Instaluar është 1 kW
- Filtri Mekanik përbehet nga keta elemente dhe ka keto karakteristika:
- Siguron shplarje me cikël automatik
- Kapaciteti i tij është 2500-6000 liter ne ore
- Dimensionet e kules: 616 x 2105 mm

## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike

- Materiali mbushes: shtrese kokrizote guresh kuarcore me permasa ne shkallezim (5 shtresa);
- Shtrese kokrizore e imet ne mbyllje te ciklit.

### *Dezinfektim i ujit me Ozon;*

- Filtrimi mekanik;
- Filtrimi me karbon aktiv i cili sherben per filtrimin e:
  - Materialeve organike;
  - Materialeve me arome te keqe e te papelqyeshme;
  - Teprices se Ozonit

### Filtrimi mekanik;

Filtrimi me karbon aktiv i cili shërben për filtrimin e:

- Materialeve organike;
- Materialeve me aromë të keqe e të papëlqyeshme;
- Tepricës së Ozonit
- Filtrimi i imet:
- Me filtra cilindrike vertikale
- 3 copë filtra, 50 cm të gjatë dhe 0,2 mikron të imët.

### Filtri i imët

- Sistem qirinjsh vertikale per optimum te filtrimit te imet,
- Imtesia e poreve te shtreses filtruese 5mikron, 10mikron, 15mikron, 20mikron.

*Ne fund te filtrimit uji del ne perputhje me normat europiane te Standartit*

### *Filtri me Karbon Aktiv*

Siguron shplarje me cikël automatik

Kapaciteti i tij është 2500-6000 liter ne ore

Dimensionet e kules: 616 x 2105 mm

Mbushja me Karbon Aktiv është 350 kg

### Lënda ë parë

Shishet plastike të vogla, PET, për bidona 0.5 litra, 1.5 litra dhe 8 litra.

### Gatitja teknologjike e ujit

Depozita e ujit të fabrikës Acqua Prima, Burimi Selitë ndodhet në burim. Në burimin Selitë përdoret rrezatimi Ultraviolet për sterilizimin e ujit. Uji merret pas daljes nga HEC-i i Lanabregasit me leje të UKT. Më pas nga depozita uji kalon në proceset e filtrimit si më poshtë:

- Filtri i karbonit;
- Filtri i precizionit;
- Holli filter (që vret të gjitha mikrobet).

## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike

Prodhimi i pijeve jo alkoolike

Pijet jo alkoolike që prodhon kjo fabrikë i nënshtrohen proceseve teknologjike si më poshtë vijon:

- Filter i madh i lëngjeve;
- Tretësi i sheqerit;
- Dy përzierësa;
- Frigorifer i ftohjes (lëngu ftohet për të marrë CO<sub>2</sub>);
- Filtri i gazit;
- Mikseri i gazit;
- Pasterizatori;
- Qypi automatik i larjes.

Bloku 3/1/1. Tre procese në një makinë (Larje, mbushje, taposje)

- Mikseri i gazit;
- Pasterizatori i shisheve të mbushura;
- Printeri i skadencës;
- Ventilatori i tharjes së shisheve;
- Etiketim;
- Kaldaja ose gjeneratori i avullit që bën ngjitjen e etiketës;
- Paketimi në koli: 1x8, 6x1.5, 12x0.5;
- Furra e paketimit.

### Termoteknika

Teknologjia e përdorur nga kjo fabrikë është pa oxhak, pasi në të nuk ndodhin procese të rënda teknologjike, kështu që gjatë punës në të nuk ka çlirim të lëndëve të ndryshme në ajër. Pak avull mund të krijohet gjatë momentit të ngjitjes së etiketës, por sasia e tij është e papërfillshme. Gjithashtu emisionet në ajër janë të papërfillshme. Mbetjet që prodhohen nga fabrika janë të papërfillshme. Gjithashtu nuk ka aspak zhurma. Edhe vibrime nuk ka. Mundësia e rënies së zjarrit është pothuajse zero, pasi çdo element është beton. Nuk ka prani druri apo dyshemeje. Është pa prani të lëndës drusore. Ujërat e zeza kalojnë në tubacionin magjstral.

### Punësimi

Gjatë dimrit në fabrikë punojnë 7 veta ndërsa në verë punojnë 12 veta.

### Marrëdhëniet me komunitetin

Shtëpitë më të afërta me fabrikën që janë 4-5 të tilla ndodhen në distancë mbi 50 metra. Banorët e tyre nuk kanë asnjë ankesë.

## TREGUESIT FIZIKO-KIMIKË DHE HIGJENIKË NË UJËRAT E PIJSHËM

*Kalciumi* - sasia në nivelin e këshilluar është 75mg/l, por sasia minimale e pranueshme është 30mg/l;

*Jodi* - norma jepet 10mg/l por kërkon dhe sasi të mjaftueshme fluori.



## **Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike**

*Oksigjeni i tretur* – norma është deri në 8mg/l.

*Alkaliniteti i përgjithshëm*– këshillohet 5mg-ekv/l

*Amoniak dhe Nitritet* – nuk këshillohet të jenë të pranishëm sasi të më të larta se 0.05 mg/l

*Kërkesa biokimike për oksigjen dhe oksidueshmëria (lëndët organike)* – këshillohet të jetë 1mg/l, por pranohet deri 3mg/l.

*Pesticidet si lindani, aldrina, dieldrina, DDT, fenolet dhe cianuret* duhet të jenë pothuajse zero.

*Fortësia e përgjithshme:* norma e këshilluar është 3.5-7.5 mg-ekv/l e pranueshme deri në 9mg-ekv/l.

*Kaliumi –K-* përmbajtja lëkundet midis 3mg/l (3ppm). gjithsesi, potasi në ujërat nuk është i normuar.

*Natriumi* – këshillohet 20mg/l dhe pranohet deri 100mg/l.

*Kalciumi* – norma e këshilluar 75mg/l, ajo e pranueshme 200mg/l.

*Magnezi* – norma 20mg/l, e pranueshme 50mg/l .

*Kloruret* –norma e këshilluar (25mg/l),

*Sulfatet* – norma e këshilluar (25mg/l). Norma e pranueshme është 250mg/l.

*Nitratet* – norma 25mg/l, e pranueshme 50mg/l. Norma e këshilluar (0.4 mg/l)

*Silica* – norma është 2.5mg/l dhe e pranueshmja 10mg/l

*Mineralizimi i përgjithshëm*– të gjitha ujërat i afrohen më tepër normës së këshilluar (700mg/l) kur norma e pranueshme është 1500mg/l.

*Fluori* – të gjitha ujërat e kanë fluorin në sasi të pamjaftueshme (norma 0.95mg/l)

*Jodi* – norma 5 mg/l.

*Hekur dy dhe trivalent* – Norma është 0.05mg/l dhe pranohet 0.3mg/l.

*Zinku* – norma 0.1mg/l dhe e pranueshme deri në 5mg/l.

*Plumbi* – norma e lejuar është 50mg/l.

*Mg, Ca, Si.* - Faktor mbrojtës në sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut. Në rastet kur kemi mungesë kalciumi ose sasi të ulët silici, kjo përbën faktor negativ dhe ndikon në rritjen e rasteve të hipertensionit dhe të sëmundjeve të zemrës.

*Lëndët organike* – deri në 50mg/l konsiderohet e lartë.

*Gaz sulfidrik* - Ujërat që përmbajnë deri në 5mg/l të përgjithshëm grupohen në ujërat minerale sulfurore. Gazi sulfidrik është nxitës i prodhimit të lëngjeve tretës të stomakut, mëlçisë dhe zorrëve.

*Mineralizimi i përgjithshëm* - Faktor tjetër veprues. 4g/l, sasi kjo shumë e përshtatshme për pirje, sepse janë ujëra kloruro-jodikë, që favorizojnë pohimin e lëngjeve të mësipërme.

*Mbi bazën e këtyre të dhënave, për pirje këto ujëra mund të përdoren në kolitë, hepatite, në sëmundje kronike të fshikës bilicore, në diabet, në helmime, me metale të rëndë (Pb, Hg, Bi), etj.*

## *Planifikimi funksional i territorit*



## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkoolike

- Territori i ri i fabrikës duhet të integrohet me territorin e ndërtimeve ekzistuese, duke ruajtur intesitetin e ulët të ndërtimeve. Ky konceptim çon në një shfrytëzim më racional të burimeve të tjera natyrore.
- Zonat e fabrikës do të plotësohen me të gjitha ndërtimet e nevojshme për një qendër funksionale teknologjike me institucionet e saj administrative, etj.
- Zonat e fabrikës duhet të ndahen nga rrugët e trafikut të jashtëm dhe sistemet e tjera me breza mbrojtës sanitar dhe territore të gjelbëra.



### *Planifikimi i infrastrukturës inxhinierike*

Koncept bazë për planifikimin e infrastrukturës do të jetë realizimi i plotë i rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve, rrjetit elektrik dhe telefonik për plotësimin e nevojave të fabrikës.

- Rrjeti inxhinierik do t'i përgjigjet zhvillimit perspektiv të fabrikës;
- Rrjeti rrugor do të shoqërohet njëkohësisht me rrjetin e infrastrukturës inxhinierike;
- Zgjidhjet emergjente të rrjetit të infrastrukturës do të bazohen në projekte afatgjata.

*Theksojmë se në infrastrukturën inxhinierike duhet të përfshihet menaxhimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane. Po këtu duhet të përfshihen të gjitha ato mekanizma ose zgjidhje alternative, që sjellin përfitime në energji rjerëzore, në përdorim efikas toke, në shfrytëzim maksimal kohe, si parkimet brenda apo nën kompleksin e punimit, furnizime me ujë, deri në sigurimin e fabrikës me energji pozitive (panela diellor, erë, gjeotermi).*

### **Ligji Nr. Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për “Mbi mbrojtjen e mjedisit”.**

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbi bazën e parimeve, kërkesave, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit.

### **L I G J Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”**

Ky ligj synon të sigurojë: a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

## **Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkoolike**

b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara së organeve qendrore dhe vendore, antarëve të publikut, organizatave jofitimprurëse, nëpërmjet një vlerësimi të integruar dhe kohor të impaktit në mjedis të projekteve dhe veprimtarive.

### **Sistemi Natyror Gjeologjik**

Njohja dhe vlerësimi i parametrave sedimentologjikë, si:

- mjediset depozituese
- faciet litologjike (ranorë, argjila, alevrolite, karbonate, surëra, suargjila),

përbëjnë një nga kushtet bazë, për zhvillim të qendrueshëm dhe afatgjatë të çdo sipërmarje teknike në sipërfaqe, si dhe për evidentimin e shkaqeve dhe të pasojave, që lidhen me mosfunksionimin normal të tyre. Në këto studime, përfshihet evidentimi i zonave të thyerjeve tektonike me aktivitet të vjetër (miliona vjeçar) dhe të ri (neotektonika), njohja e së cilave kontribuon direkt në vlerësimin e:

- zonave me aktivitet sizmik;
- zonave me subsidence të ulët e të lartë;
- zonave me aftësi të ulët e të lartë rrëshqitjeje;
- zonave me aktivitet të ulët apo të lartë të veprimtarisë së mjediseve lumore

Studimi gjeoteknik i zonës në studim lidhet sidomos me njohjen dhe vlerësimin e parametrave gjeoteknike, me kryesoret e të cileve, janë:

- rajonizimi gjeologo-inxhinjierik;
- tipizimi i prerjeve litologjike;
- klasifikimi gjeoteknik i shkëmbenjve të butë, mesatarisht të fortë, etj.;
- vetitë dhe veçoritë e dherave (peshë specifike, masë volumore, kohezion, kënd i fërkimit të brendshëm, etj).

përbëjnë gjithashtu një nga kushtet bazë për zhvillim të qendrueshëm dhe afat gjatë të çdo sipërmarje teknike në sipërfaqe, si dhe për evidentimin e shkaqeve dhe të pasojave që lidhen me mosfunksionimin normal të tyre. Studimet me karakter gjeoteknik të kryera në këtë rajon, pothuajse nuk kanë qenë fokusuar as në objekte të veçanta. Për vlerësimin dhe realizimin e programit duhet të kryen punime zbulimi dhe punime laboratorike, për përcaktimin e vetive fiziko-mekanike të dhërave dhe të formacionit rrënjësor.

Njohja dhe vlerësimi i parametrave hidrologjikë, si analiza e bilancit hidrologjik, dhe probabiliteti i ngjarjeve të jashtëzakonshme, të bëjnë, që të parashikosh rreziqet atmosferike, duke bërë të mundur të evidentosh zonat e përmytjeve, mundësinë e aktivizimit të përrrenjëve apo të luginave në dukje të thara, etj. Brenda sektorit të kërkuar gjenden burime të konsiderueshme uji, sepse sipërfaqja ujëmbledhëse është e madhe dhe vetë konfiguracioni i terrenit i krijon premisat.

### Ndikimet pozitive

Edhe pse është e pa evitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që:

- të ketë punësim të vazhdueshëm;
- të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;
- të krijojë të ardhura të konsiderueshme financiare dhe ekonomike në rajonin në tërësi;
- ndikimet mjedisore që identifikohen të eliminohen, reduktohen ose zbuten.

Sipas studimit të deritanishëm, nuk është identifikuar asnjë “ndikim fatal”, ndonëse ekzistojnë disa ndikime shumë të vogla negative, të cilat do të kontrollohen nga masat zbutëse inxhinierike.

### Ndikimet e projektit

Projekti, fabrikë e prodhimit dhe ambalazhimit të ujit, si dhe e prodhimit të pijeve jo alkolike, paraqet një sërë parametrash për t'u marrë si shembull pozitiv dhe që ia vlen t'i theksosh e t'i zbatosh në zona apo komuna të tjera, duke i hapur rrugë zhvillimit të qëndrueshëm dhe jo atij apriori.

### *Ndotja e ujit*

Derdhja e ujërave të larjes apo i mbeturinave të lubrifikanteve të motorrave, mund të krijojnë kushte për ndikime të tjera, objekt i të cilave të jetë uji nëntokësor. Ndikimi i këtyre faktorëve është “i vogël”, duke marrë në konsideratë nivelin e pajisjeve të përfshira dhe standartet me të cilat duhet të punojnë këto tip pajisjesh. Masat zbutëse përfshijnë “Praktikat më të Mira të Menaxhimit të Ndërtimit”, të cilat do të jenë një nga këkesat bazë të specifikimeve të kontratës.

### *Mbeturinat*

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë i parëndësishëm, sepse do të prodhohen mbeturina tepër të vogla nga vetë proceset e punës. Pritet gjithashtu, prodhimi i mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit. Llojet, sasi, data dhe mënyra e largimit të të gjithë mbeturinave të rëndësishme do të shënohet në një regjistër dhe për më tepër puntorëve do t'u kërkohet të mbledhin veç fraksionet e ndryshme të mbeturinave.

### *Trafik i ri shtesë i krijuar*

Lëvizjet e kamionëve për dërgimin e materialeve dhe largimin e tyre do të parashikohet që të ndodh në kohën me më pak trafik në rrjetin rrugor lokal, me qëllim që të ndërthuret sa më pak me trafikun normal të zonës suburbane dhe urbane. Kësisoj, do të jetë e udhës, që më mirë lëvizjet të kryhen kryesisht në intervalin kohor 17-07.

*Duke u bazuar në sasinë e trafikut të pritsëm të ndërtimit, kohën kur do të kryhet ky trafik, kohëzgjatjen e kufzuar të ndërtimeve intesive, si dhe në përmirësimin e rrugëve, volumin dhe*

## **Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike**

*kapacitetin e trafikut në rrugët ekzistuese, nuk parashikohet që aktivitetet e ndërtimit do të rezultojnë me ndikime negative mbi trafikun.*

### *Ndikimi mbi trafikun/rrugët tokësore*

Ndikim më i madh në trafikun tokësor do të vijë nga transporti i produkteve. Shpejtësia e kamionëve të shkarkimit do të kontrollohet, në mënyrë që të ulet rreziku i aksidenteve, duke vendosur sinjale rrugore në pikat më të nxehta të trafikut.

### *Shqetësimet estetike*

Gjatë shërbimeve, ka operacione, si ngarkim-shkarkim, lëvizja e materialeve, për të cilat nuk pritet të rezultojnë në ndonjë shqetësim të dukshëm estetik, vetëm se pritet të jenë të pranishme gjatë operacioneve ndërtimore.

### *Cënimi i interesave publike ose private*

Ndërtimet e propozuara do të kryhen me konsideratën e minimizimit të të gjitha cënimeve të interesave publike apo private.

### *Ndikimi në burimet arkeologjike dhe kulturore*

Nuk evidentohen vende arkeologjike dhe kulturore pranë në mënyrë që të merren masat e duhura dhe të vazhdueshme ndaj tyre.

### *Ndryshimet tokësore*

Këto veprimtari përfshijnë përmirësimin e aksesit në sheshet e ndërtimit, përgatitjen e shesheve të ndërtimit, kullimin e shesheve, punimet e themeleve, largimin e mbeturinave, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve, udhëtimet e punëtorëve dhe veprimtari të tjera të nevojshme për t'u kryer.

### *Dukuritë që do të ndodhin gjatë funksionimit*

Ndërtimet e mjedisve të shërbimit do të përqëndrohen në sipërfaqje të caktuara, ku operon biznesi.

### *Ndikimet në biodiversitet*

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga dridhjet, pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi, megjithëse ato janë të papërfillshme, siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si, gjelbërimi jashtë territorit të sheshit të fabrikës do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegetacionit në zonat përreth.

## **Plani i zbutjes së ndikimeve negative dhe rehabilitimet**

### *Të përgjithshme*

Mbrojtja e mjedisit është një detyrë që duhet të zgjidhet që në hartimin e projekt zbatimit të aktivitetit. Ndikimet negative kërkojnë hartimin e masave zbutese dhe rikuperimet për ndikimet negative dhe kjo realizohet me anë të tre metodave të mundshme: Evitimi ose

## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkolike

parandalimi i ndikimit; reduktimi ose korigjimi i ndikimit; dhe kompensimi ose shlyerja e ndikimit. Lloji i rekomanduar i zbutjes së ndikimit ka mundësi të varet nga një sërë faktorësh, përfshirë zbatueshmërinë teknike, praktikitetin, resurset dhe kapacitetin e disponueshëm, koston dhe nëse rekuperimi i propozuar është konsistent me planin ose programin e propozuar. Ky projekt në skemën e tij duhet të përmbajë elemente, që sigurojnë marrjen e masave në rast anomalie apo avarish, që mund të jenë deri në dëmtues të lëndës së parë apo rënie zjarri.

### Evitimi ose parandalimi

Parandalimi i ndikimeve negative është opsioni i parë dhe më i miri, në rast se është në linjë me qëllimet e tjera të programit të propozuar. Parandalimi funksionon më mirë kur zbatohet herët në procesin e vendimmarrjes dhe në një nivel strategjik. Sapo janë marrë vendimet kryesore në lidhje me një program të propozuar (psh në rastin e zhvillimit të tokës – shkalla e zhvillimit, vendndodhja dhe lloji i përdorimit i propozuar), rekuperimi ka më shumë mundësi të fokusohet në reduktimin ose shmangjen e ndikimeve.

### Reduktimi ose korigjimi

Reduktimi i ndikimeve negative ka mundësi të jetë metoda më e zakonshme. Dëmtimi në mjedis mund të jetë i pranueshëm, por kur mbahet brenda kufijve të pranueshëm. Korigjimi i ndikimeve negative është i ngjashëm me reduktimin, përveçse kryhet pasi kanë ndodhur ndikimet, për shembull rimbjellja e vegjetacionit të dëmtuar.

### Kompensimi ose shlyerja

Kompensimi ose shlyerja e ndikimeve përfshin krijimin e një përfitimi mjedisor, i cili kompenson për një dëmtim tjetër mjedisor. Vështirësia e kompensimit qëndron në sigurinë që do të kryhet.

### Monitorimi si proces

Monitorimi është procesi i zbulimit të ndryshimeve, nëse ato do të ndodhin, i përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes të tyre. Objektivi themelor i këtij kapitulli është që të ofrojë rekomandime të përshtatshme për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të mbrojtjes së cilësisë së ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në mënyrë që ai të shërbejë realisht për promocionin publik të gjithë zones përreth. Procesi i monitorimit do të përqëndrohet dhe fokusohet në aktivitetin e kësaj fabrike, në standartet dhe menaxhimin, faktorët që gjenerojnë ndikime negative në mjedis, në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Parametrat që do të monitorohen:

1. *Parametrat e prodhimit*
  - i. volumin ditor, mujor dhe vjetor të përpunimit të tyre nga pikëpamja e rezervave,
  - ii. parametrat teknologjik të grimcimit sipas standarteve për material ndërtimor
  
2. *Sasia në masë dhe vëllim të mbeturinave mujore*
  - i. Mbeturina sterilesh
  - ii. letra
  - iii. plastika
  
3. *Sasia e energjisë së harxhuar mbi baza mujore*

## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkolike

- i. Korrent
  - ii. Sasia e karburantit të gjeneratorit
  - iii. Sasia e karburantit të përdorur nga makinat e repartit
4. *Sasia dhe cilësia e ujit e konsumuar mbi baza mujore*
- i. Ujë për procese teknologjike të largjes
  - ii. Ujë për konsum për efektivin
  - iii. Ujë industrial për procese teknologjike;
  - iv. Ujë për konsum komunal;
5. *Niveli i ndotësve të ajrit*
- i. PM10
  - ii. PM2.5
  - iii. Pluhur total
  - iv.
6. *Niveli i ndotjes së zhurmave:*
- i. Në ambiente publike;
  - ii. Në ambiente të kompleksit industrial;
  - iii. Në orët e natës dhe të ditës, etj.,
7. *Niveli i ndotjes së ujrave përreth zonës*
- i. Identifikimi i prezencës së elementeve kimik të rrezikshëm;
8. *Gjendja shëndetësore e punonjësve:*
- i. Numri i ditëve me raport për shkak të sëmundjeve profesionale

Monitorimet do të kryhen nga kompania dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse. Verifikimet e monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si ARM-ja e Tiranës /Ministri e Mjedisit.

Planet e sigurisë dhe të menaxhimit të katastrofave hipotetike

Planet e sigurisë

Operatori në bashkëpunim me kontraktorin e ndërtimit dhe nënkontraktorët e tjerë, do të përgatisin planet e caktuar të sigurisë, që do të jenë si pjesë përbërëse e projektit të propozuar. Këto plane rekomandohen të bëhen nga ky studim, duhet të përfshijë sa më poshtë:

- Plani i evakuimit të njerëzve në rast alarmi (emergjence);
- Proçedurat e sigurimit në punë apo rregullat e sigurimit teknik;
- Proçedurat e mjekimit dhe të ndihmës së shpejtë në raste aksidentesh në punë;
- Emrat e personave të kontaktit dhe numrat e tyre të telefonit;
- Proçedurat e nënshtrimit apo të fikjes së zjarrit.

Skenaret e aksidentëve të mundshme

- Humbjet si rezultat i ngjarjeve të paparashikueshme:



## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkalike

- Dëmet nga ngarkesat dhe aksidentet ;
- Përplasjet e mjeteve në zone;

### *Rreziqet e pranueshme të përgjithshme*

Rreziqet në fuqinë e punës dhe publiku i gjerë futet në dy kategori:

- rrezik individual dhe
- risk social;

### *Rreziqet individuale*

Rreziku individual është përcaktuar si mundësia në një vit, që një person i pranishëm në një vend të caktuar do të aksidentohet si pasojë e moszbatimit të masave të sigurimit teknik.

*Në kuadër të planit të sigurisë duhet patur parasysh marrja e masave për zbutjen e rrezikut, si dhe të vlerësohen rreziqet individuale*

### Plani i menaxhimit të mjedisit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PNM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

### Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme

Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim ambiental i detajuar dhe një program trajnimi. Përbërësit kryesorë të këtij programi duhet të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga dy fazat kryesore të zhvillimit të kompleksit;
- Ndërtimi, Funksionimi;
- Arsyet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendim marrja;
- Trajnime specifike;
- Monitorimi i cilësisë së ujit dhe ajrit;
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;
- Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;
- Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;
- Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
- Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Kërkesat e objekteve që do të ndërtohen;
- Trajnim për inspektor/supervisor gjatë ndërtimit, duke theksuar zonat kryesore; mjedisore, ku duhet të përqëndrohen perpjekjet;



## Përmbledhje jo teknike për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit ACQUA-PRIMA dhe pijeve jo alkolike

- Mbatja, transporti dhe asgjësimi i materialve të rrezikshme,
- Procedurat për të eliminuar derdhjen gjatë funksionimit;
- Kërkesat e sigurisë dhe shëndetit;
- Mirëmbajtje;
- Monitorimi i zhurmës mjedisore;

### **Plani i menaxhimit të mbeturinave të prodhuara gjatë zbatimit të projektit**

Në brendësi të këtij Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis, janë sqaruar të gjitha llojet e mbeturinave që do të gjenerohen si gjatë përmirësimit të infrastrukturës (rrugëve, gjatë gërmimit të themeleve apo të bazamenteve të ndryshëm), si dhe ndërtimeve që do të kryhen në këtë shtet.

### AUTORË:

Prof. asc. SAZAN GURI

Ekspert Gjeomjedisi

M. sc. Marianthi GURI

Ekspert mjedisi

Prof. Dr. Genci LUARASI

Ekspert teknolog kimie

Aulent GURI

Ekspert Mjedisi

Klara KODRA

Ekspert juriste

Erisa KALEMI

Eksperte GIS

